
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 05.06.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKT:BLERJE INSTRUMENTA MUZIKORE PËR TEATRIN KOMBËTAR TË
OPERËS,BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR- KONTRATË**

VLERA E FONDIT LIMIT: 33,314,246 (tridhjetë e tre milion e treqind e katërbëdhjetë mijë e dyqind e dyzetë e gjashtë) **Lekë pa TVSH ose 349,609.046** (treqind e dyzetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntë pikë dyzetë e gjashtë) euro.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 05.06.2026 është 95.29 (nëntëdhjetë e pesë pikë njëzetë e nëntë) euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

OBJEKT Blerje pajisje (vegla muzikore) për Teatrin Kombëtare i Operës, Baletit dhe Ansambli Popullor

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3 dhe nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.*

Nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/b, AK nuk mund të tejkalojë vlerën e përlllogaritur limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të

ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se vlera e përlllogaritur për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 42/3 dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne

vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 42 pika 3 e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

Argumentimi: Publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjisllacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknik të kërkuar në DST me qëllim që komisioni të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit në adresën e autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë transportin e mallrave objekt prokurimi në adresën e autoritetit kontraktor.

4. Operatori ekonomik për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë një deklaratë garancie sipas afateve të parashikuara në Shtojcë nr.6. “Formulari i specifikimeve teknike

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së garancisë është vendosur për të garantuar që operatori ekonomik merr përsipër përgjegjësinë për cilësinë dhe funksionalitetin e mallrave objekt prokurimi gjatë periudhës së garancisë së përcaktuar në Shtojcën nr. 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”. Kjo kërkesë i shërben mbrojtjes së interesave të autoritetit kontraktor, duke siguruar zëvendësimin, riparimin ose eliminimin e defekteve që mund të shfaqen gjatë periudhës së garancisë, pa kosto shtesë për autoritetin kontraktor. Kriteri është në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt me ekzekutimin e saj.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Specifikimet teknike për veglat muzikore janë hartuar mbi bazën e nevojës institucionale për furnizim me instrumente të nivelit të lartë profesional orkestral dhe koncertal, të domosdoshme për realizimin e aktiviteteve artistike dhe edukative në standard të avancuar interpretimiga Orkestra Simfonike Kombëtare e Republikës së Shqipërisë.

Veglat muzikore kërkohen për përdorim në formacione orkestrale profesionale dhe solistike, ku kërkohet stabilitet i lartë i intonacionit, homogjenitet i tingullit, reagim teknik i avancuar dhe kontroll dinamik i saktë.

Kërkesa për instrumente të nivelit profesional bazohet në nevojën funksionale për të garantuar:

1. interpretim të saktë muzikor në kontekst orkestral;
2. stabilitet tonal në të gjitha regjistrat;
3. homogjenitet të tingullit në ansambël;
4. reagim teknik të avancuar në repertor kompleks;
5. qëndrueshmëri në përdorim intensiv koncertal.

Instrumentet e niveleve studentore ose gjysmë-profesionale nuk përmbushin këto kërkesa për shkak të kufizimeve në mekanikë, intonacion dhe cilësi materiale, dhe për këtë arsye nuk janë të përshtatshme për përdorim orkestral profesional.

Specifikimet janë hartuar mbi parimet e mëposhtme:

1. nevojë reale funksionale dhe artistike;
2. proporcionalitet me përdorimin e synuar;
3. referim në standarde ndërkombëtare profesionale.

Instrumente frymore (Flaut piccolo, Flaut, Oboe, Klarinetë, Fagot)

Instrumentet frymore kërkohen për përdorim orkestral dhe solistik profesional dhe duhet të sigurojnë minimalisht:

1. intonacion të qëndrueshëm dhe të saktë në të gjithë diapazonin tonal;

2. reagim të shpejtë dhe kontroll teknik të avancuar;
3. timbër homogjen dhe të balancuar në ansambël;
4. mekanikë profesionale me precizion të lartë dhe toleranca të ulëta funksionimi;
5. materiale cilësore që garantojnë rezonancë dhe stabilitet;
6. përshtatshmëri për përdorim të vazhdueshëm koncertal dhe edukativ profesional.

Kjo kategori përfshin: Flaut Piccolo, Flaut, Oboe, Klarinetë dhe Fagot për të cilat kërkohet standard orkestral profesional i krahasueshëm me instrumentet e përdorura në orkestra simfonike simotra.

Instrumente tunxhi (Korno, Trombë, Trombon)

Instrumentet e tunxhit duhet të garantojnë:

1. projeksion të fuqishëm dhe të kontrolluar të tingullit;
2. stabilitet të intonacionit në të gjitha regjistrat;
3. balancë akustike në përdorim orkestral;
4. mekanizma me precizion të lartë (valvula ose slide);
5. materiale të qëndrueshme të standardit orkestral profesional;
6. rezistencë ndaj përdorimit intensiv dhe kushteve klimatike.

Kjo kategori përfshin: Korno, Trombë dhe Trombon të përshtatshme për repertor orkestral profesional dhe koncertal.

Harpa

Harpa duhet të sigurojë standard koncertal profesional duke përfshirë:

1. stabilitet të lartë të akordimit;
2. rezonancë të pastër dhe të balancuar në të gjithë diapazonin;
3. mekanizëm preciz të sistemit të pedaleve;
4. ndërtim nga materiale akustike cilësore;
5. ndjeshmëri të lartë dinamike për interpretim artistik;
6. lehtësi në montim, transport dhe përdorim skenik;
7. përshtatshmëri për përdorim orkestral dhe koncertal profesional.

Instrumente perkusioni (Timpan, Daulle e madhe, Këmbana tubolare, Tamburinë, Pjata, Daulle snare, Pjatë e varur, Kasanjeta, Trekëndësh)

Instrumentet e perkusionit duhet të përmbushin:

1. qëndrueshmëri të lartë strukturore dhe mekanike;
2. kontroll të saktë dinamik dhe përgjigje ritmike të qartë;
3. materiale profesionale që sigurojnë cilësi të qëndrueshme tingulli;
4. stabilitet tonal dhe uniformitet në kontekst orkestral;
5. lehtësi në montim, transport dhe përdorim skenik;
6. rezistencë ndaj përdorimit afatgjatë dhe goditjeve të përsëritura.

Kjo kategori përfshin: Timpan, Daulle e madhe, Këmbana tubolare, Tamburinë, Pjata, Daulle snare, Pjata e varur, Kasanjeta dhe Trekëndësh.

Specifikimet janë hartuar për të:

1. garantuar nivel të lartë artistik dhe teknik;
2. siguruar përdorim të qëndrueshëm orkestral;
3. minimizuar rrezikun e furnizimit me instrumente të papërshtatshme;

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë objektive, funksionale dhe jodiskriminuese, duke u bazuar në nevojat reale artistike dhe institucionale. Ato sigurojnë cilësi të lartë profesionale orkestrale dhe janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të performancës muzikore.

GARANCIA

Sa më lart cituar, periudha minimale e garancisë duhet të jetë jo më pak se 2 (dy) vjet nga data e marrjes në dorëzim dhe nënshkrimit të procesverbalit të pranimit të të gjithë mallrave objekt prokurimi.

Për harpën koncertale dhe timpanët profesionalë garancia minimale duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë) vjet për elementët strukturorë dhe mekanikë kryesorë. Garancia duhet të mbulojë riparimin dhe/ose zëvendësimin e pjesëve me defekt që rrjedhin nga aspekte prodhimi, materiali, montimi etj., gjatë përdorimit normal profesional të mallrave objekt prokurimi. Operatori ekonomik duhet të sigurojë servis teknik, pjesë këmbimi dhe mbështetje teknike gjatë gjithë periudhës së garancisë.

Orkestra Simfonike e Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor është e angazhuar në realizimin e shfaqjeve artistike të të gjitha drejtorive artistike të këtij institucioni (të Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë, Drejtorisë së Baletit dhe Drejtorisë Artistike të Ansambilit të Këngëve dhe Valleve Popullore), si brenda dhe jashtë ambienteve të institucionit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Këto shfaqje përfshijnë premiera dhe repertore të operave, musicaleve, operetave, galave, baleteve, koncerteve (simfonike, vokalo-simfonik, simfoniko-korale, mesha etj.) apo shfaqjeve ekskluzive duke përfshirë ndër të tjera edhe teatrin për fëmijë.

Të gjitha specifikimet teknike të përshkruara më sipër janë kërkesa minimale funksionale dhe performancë. Referencat eventuale ndaj standardeve, teknologjive ose konfigurimeve duhet të kuptohen si "ose ekuivalente".

NJËSIA E PROKURIMIT: